



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO	
KOMUNA E VUSHTRRISË-OPŠTINA VUČITRN	
01 Nr. / Br.	25/21
Nr. i fq. / Br. st.	-5-
Data: / Datum	11.02.2021
VUČITRN	



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA

KOMUNA VUSHTRRI
OPŠTINA VUCITRN

PROCESVERBAL

nga mbledhja e I-rë e Komitetit për Politikë dhe Financa, mbajtur më
14 janar 2021 në sallën e kryetarit të komunës, e cila filloi në ora 13:35.

Në mbledhje ishin të pranishëm: Nasuf Aliu (kryesues), Melihate Basholli-Latif, Ymer Haradinaj, Shkëlzen Feka, Arta Ymeri, Nezir Klinaku dhe Teuta Aruçi Shartari (anëtarë të KPF-së).

Munguan: Shpëtim Zhegrova dhe Gresa Muli.

Gjithashtu në këtë mbledhje morën pjesë edhe: Drejtorët e drejtorive (Lutfi Gërguri, Mehmet Selaci dhe Agron Përçuku), Islam Latifi, koordinator i certifikuar për sistemin e menaxhimit të performancës, si dhe nga sekretaria e kuvendit Bujar Klinaku.

Lutfi Gërguri, drejtor i Drejtorisë për Buxhet dhe Financa – i njoftoi të pranishmit se për kuvend do t'ua dërgojmë një propozim – vendim lidhur me shpërndarjen e të hyrave të tejkaluara për buxhetin e vitit 2020.

Komiteti për Politikë dhe Financa njëzëri aprovoi këtë:

R E N D D I T E

- Shqyrtimi dhe aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e Komitetit për Politikë dhe Financa, mbajtur më 15 dhjetor 2020;
 - Shqyrtimi i Raportit vjetor mbi të hyrat dhe shpenzimet buxhetore;
 - Shqyrtimi i Informatës vjetore lidhur me punën e Drejtorisë për Administratë;
 - Shqyrtimi i Raportit të performancës së komunave për vitin 2019;
 - Shqyrtimi i Raportit Vjetor të Komitetit për Komunitete për vitin 2020;
 - Të ndryshme.
-
- Shqyrtimi dhe aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e Komitetit për Politikë dhe Financa, mbajtur më 15 dhjetor 2020.

Komiteti për Politikë dhe Financa njëzëri aprovoi procesverbalin e datës 15 dhjetor 2020.

- Shqyrtimi i Raportit vjetor mbi të hyrat dhe shpenzimet buxhetore.

Lutfi Gërguri, drejtor i Drejtorisë për Buxhet dhe Financa – tha se përkundër situatës që ka mbretëruar në vitin 2020 (pandemia Covid 19) jemi të kënaqur me shpenzimin e buxhetit, ku 87% është shpenzuar në tërsi.

Ai tha se ka mundësi që te shpenzimet kapitale të bie përqindja, pasi që kemi bërë disa pagesa më datat 25 dhe 26 dhjetor, ku ato po figurojnë si shpenzim, por që nuk janë ekzekutuar ende.

Ymer Haradinaj, anëtar i KPF-së – pyeti se në tabelë thuhet që <shpenzimet përvendime gjyqësore për shujta dhe shpenzime të udhëtimit për punëtorët e arsimit këtë vit kanë qenë 692,840.82€ ku janë ekzekutuar përmes përmbaruesit dhe thesarit qendor>. Pasi që vendimet gjyqësore po janë në favor të mësimdhënësve, për shkak se kontrata kolektive e nënshkruar nga qeveria dhe sindikata po ua mundëson një gjë të tillë, ai pyeti se a ka mundësi ligjore që komuna të gjej ndonjë formë të ujdisë përvrealizimin e këtyre mjetet financiare, pa u krijuar edhe shpenzime shtesë.

Lutfi Gërguri, drejtor i Drejtorisë për Buxhet dhe Financa – tha se kemi provuar të gjejmë një ujdi por nuk kemi arritur një gjë të tillë.

Melihate Basholli-Latifë, anëtare e KPF-së – tha se do të kërkoj edhe në kuvend që të bëhet një auditim i brendshëm lidhur me mjetet financiare që disa mësimdhënës (në mesin e tyre edhe unë) i kemi kthyer mjetet financiare <cash>, ku nuk kemi marrë asnje dëshmi përvto.

Ymer Haradinaj, anëtar i KPF-së – lidhur me mjetet financiare që e ceku Melihatja, ai tha se na u kanë ndarë mjetet financiare më shumë me vendim të inspektoratit dhe gabimi është bërë nga inspektorati në shumat financiare. Në marrëveshje me drejtorët e shkollave dhe kryetarët e sindikatave dhe drejtorin e arsimit jemi pajtuar që të kthehen ato mjetet. Në shkollën ku unë punoj, jam edhe kryetar i sindikatës, mësimdhënësit mjetet i kanë dorëzuar te unë, e pastaj unë i kam kthyer te përmbaruesi, ku i posedoj të gjitha ato shënimet.

Pas debatit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja njëzëri rekomandoi që të procedohet përvshqyrtim në Kuvend, në mbledhjen e radhës.

3. Shqyrtimi i Informatës vjetore lidhur me punën e Drejtorisë përv Administratë.

Mehmet Selaci, drejtor i Drejtorisë përv Administratë – theksoi se problemi kryesor në drejtori ka qenë reduktimi i stafit, ku na ka paraqitur vështirësi përv një ofrim më efikas të shërbimeve përv qytetarët. Shpresojmë që të hiqet pandemia Covid 19 dhe t'i kthehem normalitetit.

Ai kërkoi nga kuvendi që vendimet të cilat i merr të parashikohet edhe vështirësitet teknike. Kjo pasi që, në Qendrën përv Shërbime me Qytetarë kemi vetëm tre punëtorë dhe kemi mungesë të kapaciteteve, sepse të gjitha kërkuesat e qytetarëve adresohen në atë zyrë. Pra, të shihet mundësia përv rritjen e stafit në këtë zyrë.

Nezir Klinaku, anëtar i KPF-së – pyeti se a mbahet vetëm një protokoll në Komunën e Vushtrrisë, apo mbahet protokolle edhe nëpërv drejtori?

Mehmet Selaci, drejtor i Drejtorisë përv Administratë – theksoi se edhe drejtoritë mbajnë protokolle.

Nezir Klinaku, anëtar i KPF-së – theksoi se e përkrahu drejtorin përv forcimin e Qendrës përv Shërbim me Qytetarë, sepse ka disa vite që e kam ngritur si shqetësim që ajo zyrë duhet të

plotësohet me staf dhe çdo kërkesë të protokollohet, skanohet dhe iu adresohet drejtorive, dhe në këtë mënyrë të jetë vetëm një protokoll në komunë.

Ai pyeti se a mund të bëni një krahasim se sa persona po vdesin gjatë vitit në Komunën e Vushtrrisë dhe sa personave po iu paguhen shpenzimet e varrimit?

Mehmet Selaci, drejtor i Drejtorisë për Administratë – tha se nuk mund ta bëjmë atë krahasim, sepse qytetari i Vushtrrisë aty ku vdes (psh. vdes në një komunë tjetër) bëhet edhe regjistrimi i vdekjes. Gjatë pandemisë, kanë vdekur qytetarë të komunave tjera në spitalin e Vushtrrisë, por vdekja është regjistruar në komunën tonë.

Sipas ligjit, për ta varrosur një qytetar duhet të merret leja e varrimit në zyre e gjendjes civile, por kjo nuk është aplikuar nga Bashkësia Islame. Të paktën bile kanë mundësi që t’ia bashkëngjesin konstatimin e mjekut që e ka konstatuar vdekjen, pastaj t’iu paguhen shpenzimet e varrimit.

Nezir Klinaku, anëtar i KPF-së – deklaroi se është e çuditshme pse Bashkësia Islame nuk pranon që familjari së bashku me konstatimin e mjekut të shkoj në gjendjen civile dhe ta merr lejen e varrimit.

Melihate Basholli-Latifë, anëtare e KPF-së – pyeti se pse nuk janë duke funksionuar e-kiosqet? Pasi që qytetarët po kanë vështirësi nganjëherë për t’u pajisur me dokumente.

Edhe një shqetësim tjetër është se ka raste kur qytetarët psh. në ora 14:30 kanë ardhur për të kryer shërbime në gjendjen civile, zyrtarët iu kanë thënë që eja nesër.

Edhe unë jam përkrahëse që të rritet numri i punëtorëve në Drejtorinë për Administratë.

Mehmet Selaci, drejtor i Drejtorisë për Administratë – nëse qytetari aplikon për marrjen e certifikatës, ai pajiset brenda një minute. Por, nëse bën kërkesë për ndryshime dhe përmirësimë, atëherë janë afatet ligjore që duhet të pritet.

Lidhur me e-kiosqet, kur kam ardhur në drejtori i kam gjetur jashtë funksionit, i kemi kthyer përsëri në funksion, ku kanë funksionuar rrëth dy vite. Pastaj, përmes një projekt i të USAID-it ka qenë qëllimi që të shtohen edhe tatimi në pronë dhe fleta poseduese. Por, prej asaj kohe nuk kanë qenë funksionale.

Nezir Klinaku, anëtar i KPF-së – pyeti se e-kiosqet a janë të kundërligjshme?

Mehmet Selaci, drejtor i Drejtorisë për Administratë – tha se ka pasur raste që qytetari ka tentuar të marrë me letërnjoftim të tij dokument personal, por i ka dal ekstrakti i dikujt tjetër, për shkak të vjetërsisë së pajisjeve, sepse teknologjia po ec.

Nezir Klinaku, anëtar i KPF-së – tha se ka ardhur në përfundim se e-kiosqet janë të kundërligjshme. Kjo përfundim se, qytetari nuk mund të merr dokument për dikë tjetër, kurse në e-kiosk me letërnjoftim të kujt duash pajisesh me dokumente.

Jam interesuar se a ka e-kiosqe në vendet perëndimore dhe se në Zvicër e Belgjikë e kam vërtetuar se nuk ka.

Mehmet Selaci, drejtor i Drejtorisë për Administratë – theksoi se tek mbrojtja e të dhënave personale ka vend për kritikë, sepse nuk mbrohen sa duhet përmes e-kiosqeve.

Pas debatit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja njëzëri rekomandoi që të procedohet për shqyrtim në Kuvend, në mbledhjen e radhës.

4. Shqyrtimi i Raportit të performancës së komunave për vitin 2019.

Islam Latifi, koordinator i certifikuar për sistemin e menaxhimit të performancës – theksoi se jemi vonuar paksa në shqyrtimin e këtij raporti, sepse flitet për vitin 2019, ku është publikuar diku në muajin shtator të vitit 2020. Arsyja ka qenë se kanë ekzistuar disa paqartësi lidhur me grantin e performancës, se disa komuna nuk i kanë plotësuar kriteret e qasjes së atyre granteve dhe ka pasur dilema se a do ta merr karakterin zyrtar apo jo. Ky raport u publikua vitin e kaluar dhe e kemi obligim që ta diskutojmë në kuvend, sepse kur bëhet matja e raportit tjetër matet edhe ky tregues se a është diskutuar në kuvend apo jo.

Nezir Klinaku, anëtar i KPF-së – deklroi se sa e pashë në raport, jemi ulët tek çështja e kanalizimit.

Islam Latifi, koordinator i certifikuar për sistemin e menaxhimit të performancës – tha se jemi ulët te kanalizimi për shkak se si tregues matet edhe trajtimi i ujërave të zeza.

Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja njëzëri rekomandoi që të procedohet për shqyrtim në Kuvend, në mbledhjen e radhës.

5. Shqyrtimi i Raportit Vjetor të Komitetit për Komunitete për vitin 2020.

Nasuf Aliu, kryesues i kuvendit dhe i KPF-së - tha se për kuvend të përmirësoset ky raport dhe të bëhet një formë më standarde e raportit

Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja njëzëri rekomandoi që të përmirësoset dhe të procedohet për shqyrtim në Kuvend, në mbledhjen e radhës.

6. Të ndryshme.

Nezir Klinaku, anëtar i KPF-së – lidhur me vërshimet e fundit në Komunën e Vushtrrisë, deklroi se fajtor kryesor janë qytetarët, pasi që të gjitha kanalet kulluese janë mbyllur. Por, ai tha se nuk është mirë edhe nga kryetari i komunës të postoj foto në facebook dhe të bënë krahasime në mes vitit 2017 dhe vitit 2021. Kryetari e ka postuar këtë foto pa ndodhur vërshimet, kurse pas dy dite ndodhën vërshimet në komunën tonë. Kryetari nuk e ka ditur që niveli i lumen Silnica ritet tek pas 24 orëve, pas reshjeve të shiut.

Arta Ymeri, anëtare e KPF-së – deklroi se në fshatin Nedakoc, një ditë para vërvshime ishin disa zyrtarë të komunës, në mënyrë që qyteti mos të vërvshohet, pikërisht në vendin ku është ndërruar kahja e lumenit, me disa bagera kanë provuar ta bllokojnë bankinën, që fshati të vërvshohet e të shpëtohet qyteti. Në ora 5:00 të mëngjesit, lumi Drenica ka ardhë në lumin Silnica dhe ka shpërthyer dhe pastaj kanë filluar vërvshimet.

Nasuf Aliu, kryesues i kuvendit dhe i KPF-së- deklaroi se për vërshimet ndoshta nuk është mirë të ngutemi, sepse disa qytetarë më kanë shkruar privatisht se është mirë të bëhet kështu apo ashtu. Jemi në një fazë që mund të kemi vërvshime prapë dhe se njerëzit ende shtëpitë dhe oborret i kanë me ujë. Prandaj, komisioni për vlerësim të dëmeve ta bëjë një vlerësim real të dëmeve nga vërvshimet.

Ymer Haradinaj, anëtar i KPF-së – tha se për kuvend të na përgatisin një informatë për vërvshimet e fundit.

Po ashtu, Haradinaj paraqiti si shqetësim kërkesën e lagjës “Bregaj” në Stanoc lidhur me dëmtimin e një ure. Banorët po kërkojnë që të rregullohet kjo urë, sepse pas vërvshimeve të fundit kanë mbetur të myllur.

Nezir Klinaku, anëtar i KPF-së – edhe unë kërkoj që në kuvend të na sjellin një informatë për vërvshimet në komunën tonë.

Komiteti për Politikë dhe Financa rekomandoi që të sjellet një informatë lidhur më vërvshimet në kuvendin e komunës.

Mbledhja përfundoi në orën **14:40**.

Bujar Klinaku

Bujar Klinaku

Procesmbajtës



Nasuf Aliu

Kryesues i KK-së dhe i KPF- së